



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 15 shkurt 2021
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Parashtrim i dosjes paraprake me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

1. Në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores¹ dhe sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 4 shkurt 2021², Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqet si vijon:

- a. dosjen paraprake të Prokurorisë, që përmban një përmbledhje të provave që ZPS-ja synon të paraqesë për të provuar akuzat që përmban Aktakuza;³
- b. listën e dëshmitarëve që ZPS-ja synon të thërrasë ose ndryshe në të cilët synon të mbështetet në gjykim, me informacionin që kërkohet sipas rregullës 95(4)(b);⁴ dhe
- c. listën e provave materialeve të propozuara që ZPS-ja synon të paraqesë në gjyq.⁵

2. Në momentin e paraqitjes së këtij parashtrimi, po vijojnë diskutimet me Mbrojtjen mbi mundësinë e dakordësimit për disa fakte lidhur me akuzat. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes të mbajtur më 1 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i dha Mbrojtjes afat deri më 1 mars 2021 për të vendosur nëse do të pajtohej me ndonjë nga faktet e propozuara nga ZPS-ja më 21 janar 2021⁶. Si pasojë, në këtë fazë ZPS-ja nuk është në gjendje të paraqesë në përputhje me rregullën 95(4)(a), 'ndonjë lloj pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes si dhe një listë të pikave të pakontestuara'. ZPS-ja do të informojë pa vonesë Gjykatësin e Procedurës Paraprake sapo të përfundojnë diskutimet me Mbrojtjen.

¹Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha referencat 'rregulla', apo 'rregullat' i referohen Rregullores, përveçse kur specifikohet ndryshe.

² Urdhër për parashtrime të mëtejshme mbi nxjerrjen e provave, KSC-BC-2020-05/F00073, 4 shkurt 2021, publik, para.14(c).

³ Shtojca 1.

⁴ Shtojca 2.

⁵ Shtojca 3. Në lidhje me këtë, ZPS-ja vëren se deri tani Mbrojtja nuk ka shprehur asnjë kundërshtim konkret për vërtetësinë e ndonjërit prej këtyre dokumenteve

⁶ Konferenca mbi ecurinë e çështjes e datës 1 shkurt 2021, KSC-BC-2020-05, f. 155.

3. Dosja e procedurës paraprake, lista e dëshmitarëve dhe lista e provave janë parashtruar si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* për të ruajtur masat mbrojtëse të autorizuara më parë. Do të parashtrohet edhe një version i redaktuar konfidencial i këtyre dokumenteve.

Numri i fjalëve (në origjinal): 315

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E hënë, 15 shkurt 2021

Në Hagë, Holandë